

# RELACION

## PËR

### PROJEKTVENDIMIN

#### **“PËR PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIK TË VITIT 2020”**

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Qëllimi i projektvendimit është propozimi i projektligjit të buxhetit faktik të Qeverisjes së Përgjithshme të vitit 2020.

Objektivi që synohet është plotësimi i kërkesës ligjore (të nenit 62 dhe 63 të ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar”) për raportimin e zbatimit të buxhetit të vitit 2018, të llogarive vjetore për transaksionet financiare të entiteteve të qeverisjes së përgjithshme (qeverisjes qendrore, vendore dhe fondeve speciale të sigurimeve shoqerore, shëndetsore dhe të trajtimit të pronave) dhe informimin për arritjen e objektivave, situatën e menaxhimit, të kontrollit të brendshëm financiar dhe auditimit të brendshëm.

#### **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Lidhja me prioritetet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë: “Sektor publik i besueshëm, eficient dhe transparent”

#### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Publikimi i informacionit të plotë mbi performancën makro-fiskale dhe zbatimin e Buxhetit të vitit 2020, objektivat e arritura dhe produktet e realizuara nga çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 62 dhe 63 të ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar”.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)**

Lidhja me prioritetet e BE-së: “Rule of law”

## **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projektvendimi përmban Pikën 1 që përcakton:

Pika 1 Propozimin e projektligjit “Për Buxhetin Faktik të të vitit 2020”, sipas tekstit, relacionit, raporteve dhe tabelave bashkëlidhur tij.

### **PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Projektakti është hartuar nga strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

## **VIII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Nuk shoqërohet me të ardhura apo shpenzime buxhetore.

**PROPOZUESI**

**MINISTRI I FINANCAVE DHE EKONOMISË**

**ANILA DENAJ**